



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E ARKIVAVE**

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA GLLOGOC

Nr. 400-6162 prot.
Drenas, më 29.11.2022

MARRËVESHJE

PËR

**BASHKËPUNIM NË OFRIMIN E SHQENDËRZUAR TË SHËRBIMIT TË SALLËS
SË STUDIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË QYTETIN E DRENASIT, REPUBLIKA E
KOSOVËS**

NENI 1

Përkufizime

1. Salla e studimit është ambienti pranë të cilit studiuesi/ kërkuesi do të konsultojë materialet e kërkua nga ai vetë me qëllim studimi apo interesimi personal.
2. Kënd Arkivor do të quajmë hapësirën e cila do të jetë e percaktuar brenda bibliotekës së qytetit, ku të jenë të vendosur dy kompjutera të cilët do të jenë në shërbim të studiuesve për të konsultuar materialin arkivor.
3. Studiues/ kërkues është çdo person i interesuar që ka kryer regjistrimin në adresën katalogu.arkiva.gov.al dhe që i është miratuar.
4. “Shqendërzimi i shërbimit të sallës së studimit” është shërbimi që do të ofrojë Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bibliotekat e komunave, në të njëjtën mënyrë si në “sallën e studimit” të DPA në Tiranë.

NENI 2

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i marrëveshjes është ofrimi i shërbimit të sallës së studimit të të gjitha arkivave që janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), si shërbim i shqendërzuar në bashkëpunim me Komunën e Glllogocit.

R-10

2. Ky shërbim i mundëson komunitetit shkencor të qytetit të Drenasit dhe rrethinave të kenë qasje të plotë dhe të njëllojtë me sallën e studimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja i shërben Komunës së Glllogocit që të nxisë kërkimin shkencor në Drenas dhe të rrisë frekuentimin në sallën e studimit.
4. Marrëveshja i shërben Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të rritur interesin e komunitetit shqiptar jashtë vendit për pasuritë arkivore të historisë sonë kombëtare.

NENI 3

Objekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka si objekt përcaktimin e detyrimeve reciproke dhe rregullave për realizimin e ofrimit të shërbimit të Sallës së Studimit të DPA në mjediset e bibliotekës të qytetit të Drenasit.

NENI 4

Ofrimi i shërbimit

1. Shërbimi për studiuesit do të ofrohet me të njëjtat rregulla, të njëjtat procedura, të njëjtën shpejtësi dhe të njëjtën formë siç ofrohet në Sallën e Studimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.
2. Në qytetin e Drenasit, shërbimi do të ofrohet në këndin e posaçëm të krijuar në Sallën e Studimit të Bibliotekës së Drenasit.
3. Shërbimi do të ofrohet përmes sistemeve elektronike të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe sipas detyrimeve që bien dakord palët në këtë marrëveshje.

NENI 5

Detyrimet e palëve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave merr përsipër:
 - a. Të instalojë, mirëmbajë, përditësojë dhe menaxhojë sistemin elektronik të shërbimit në Këndin Arkivor Drenas.
 - b. Të trajtojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të asistojë punonjësit të Bibliotekës së Drenasit për hapjen e programit, kthimin e përgjigjeve standarde mbi pyetje që mund të kenë studiuesit mbi procedurën.
 - c. Të ofrojë falas shërbimin e saj në Bibliotekën e Drenasit, në të ardhmen inventarë të arkivave në varësi të saj, sipas mundësive të DPA, të cilat shërbejnë sipas rregullave të bibliotekës.
2. Komuna Glllogoc merr përsipër:
 - a. Të garantojë një hapësirë fizike në sallën e studimit për Këndin Arkivor Drenas, ku duhet të jenë minimalisht dy (2) kompjutera dhe lidhja me internet, me specifikime minimale sipas shtojcës bashkëlidhur. Vendosja e Këndit Arkivor do të dakordësohet nga të dyja palët. Komuna Glllogoc, në kuadër të politikave të saj për mbështetjen e elitës studimore të qytetit, vendos vet, në bazë të kërkesave, për rritjen e sasisë së posteve të punës të përcaktuara në këtë gërmë.

BU

- b. Të vendosë sinjalistikën e nevojshme për Këndin Arkivor, konkretisht: tabelë në hyrje të sallës, tabelë në Këndin Arkivor dhe tabelë me rregullat për studiuesit në Këndin Arkivor, sipas shtojcës bashkëlidhur.
- 3. Punonjësi i sallës:
 - a. Do të shërbejë si pikë kontakti me Përgjegjësin e Sallës së Studimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave
 - b. Ka për detyrë të ndezë kompjuterat e Këndit Arkivor dhe të hap programin VPN.
 - c. Udhëzon studiuesin në bazë të trajnimeve të marra.

NENI 6

Komunikimi dhe pikat e kontaktit

1. Komunikimi nëpërmjet punonjësit të Sallës së Studimit të bibliotekës së qytetit të Drenasit dhe përgjegjësit të Sallës së Studimit të DPA do të zhvillohet sipas pikave:
 - a. Me komunikim "Skype" ose telefonik për probleme të cilat kërkojnë asistencë të shpejtë.
 - b. Me komunikim e-mail për probleme që mund të lindin, por që kërkojnë një analizë ose afat me të gjatë zgjidhje.
2. Pikat e kontaktit:
 - a. Punonjësi i Sallës së Studimit të bibliotekës së qytetit të Drenasit dhe Përgjegjësi i Sallës së Studimit në DPA do shërbejnë si pika kontakti.
 - b. Palët janë të detyruara të njoftojnë menjëherë ndryshimin e personit të kontaktit dhe të dhënat e tij (numër telefoni, email) në adresën zyrtare të palës tjetër.

NENI 7

Detyrimet financiare

1. Marrëveshja nuk ka efekte apo detyrime financiare midis palëve .

NENI 8

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

1. Marrëveshja ka kohëzgjatje pa afat.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje, 1 (një) për secilin institucion.

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME
E ARKIVAVE

PROF. AS. DR. ARDIT BIDO

PËR
KOMUNËN GLLOGOCIT

RAMIZ LLADROVCI



SHTOJCA

Specifikimet minimale të kompjuterave duhet të jenë: Minimum dual core, 2 GB Ram, Windows 7. Specifikimet minimale të ekranit duhet të jenë: madhësia 22 inch. Shpejtësia minimale e internetit: 8 Mbs.

Shembulli 1

			
REPUBLIKA E SHQIPËRISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE SALLA E STUDIMIT KËNDI ARKIVOR DRENAS			
RREGULLORE			
1. Këndi Arkivor shërben vetëm për efekt studimor. Nëse dëshironi dokumente pronësore, amza shkollore, vjetërsi pune e dokumente të tjera biografike të Republikës së Shqipërisë, duhet të bëni aplikim në faqen kerkesa.arkiva.gov.al , jashtë Këndit Arkivor.			
2. Studiuesi gjatë kohës që shfrytëzon Këndin Arkivor është i detyruar të zbatojë rregulloren e Bibliotekës së Komunës Glllogoc.			
3. Regjistrimi në Sallën e Studimit kryhet nga çdo kompjuter me lidhje me internet, jashtë këtij Këndi Arkivor, në adresën katalogu.arkiva.gov.al . Pas aprovimit, që zgjat një ditë pune, do të pajiseni në e-mailin tuaj me fjalëkalimin për të hyrë në Sallën e Studimit.			
4. Pasi të jeni regjistruar, mund të porosisni dosjet që dëshironi të konsultoni, si në këtë Kënd Arkivor, ashtu edhe në çdo kompjuter tjetër që ka lidhje me internet, në adresën katalogu.arkiva.gov.al .			
5. Dosjet e porositura nga ju do të shërbejnë ditën që keni përzgjedhur në sistem dhe do të qëndrojnë të qasshme për pesë ditë pune.			
6. Nëse dëshironi të porosisni kopje dixhitale të një ose disa dokumenteve, ndiqni udhëzimet që ofron sistemi, përfshi edhe mënyrat e pagesës.			
Për	më	shumë	na vizitoni në

www.arkiva.gov.al

Kontakte: dpa@arkiva.gov.al

-Tabela 1. (E varur në mur, pas Këndit Arkivor, sipas shembullit 1)

Specifikimet: me përmasat 50x100 cm, materiali Etalbond 5mm + adezive me 4 distanciator, diametër distanciatori 1.1 cm.

-Tabela 2 (E varur në tavan, në fillim të Këndit Arkivor, sipas shembullit 2)

Specifikimet: Me përmasat 60x30 cm, materiali Etalbond 5mm + adezive, me varje në mur vertikale.

-Tabela 3 (Jashtë institucionit, sipas shembullit 2)

Specifikimet: Me përmasat 120cm X 60cm, materiali plexiglass 10 mm i printuar, e inkastruar në mur me 4 distanciatorë, printim UV me relief dhe diametër distanciatori 1.1 cm.

Shënim: Në të tre tabelat, teksti “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave” dhe “Salla e Studimit” duhet të jenë me të njëjtën madhësi fonti. Teksti “Këndi Arkivor Drenas” duhet të ketë madhësi më të madhe, aq sa të marzhet e saj të jenë të njëjta me tekstin “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”. Logo e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave duhet të jetë

në raportin 1:1 në lartësi me të gjithë tekstin, ndërsa në gjerësi të ruaj raportin e vet.

Shembulli 2

